



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
27.02.2026**

Me datë 27.02.2026, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Alma Mehmetaj, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Erlinda Kavaja, Gjovalin Ndoj, Florian Bjanku, Irena Shala, Valjeta Bajraktari, Artan Haxhi, Gjenarin Kapcari, Elis Doci, Irma Kopliku, Joniz Osmanagaj, Eliona Shkrela, Aleksander Pashuku, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Imeldi Sokoli, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Violeta Perndrecaj, Marina Duhani, Sead Jusha, Samed Bushati, Suada Kopshti, Fatmir Vojvoda, Muharrem Shkjau, Amina Lici, Mirsad Basha.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2026".*
2. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
3. *Projektvendim: "Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër".*
4. *Projektvendim: "Për në ndryshim në VKB nr.54 datë 30.09.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë".*
5. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2027-2029".*
6. *Projektvendim: "Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028", si dhe për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025.*

7. *Projektvendim: "Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", projekti "Shtëpia që ndërton të ardhmen" – Rikonstruktion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç).*
8. *Projektvendim: "Për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit "Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative, 2026 – 2028".*
9. *Projektvendim: "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2016 "Për taksat e tarifat vendore në Bashkinë Shkodër", të ndryshuar.*
10. *Projektvendim: " Për një ndryshim në VKB nr.18 datë 20.07.2023 "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore "Pruemos Sheldi", Nësia administrative Gur i Zi, fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Volitalia Albanie" i ndryshuar.*
11. *Projektvendim: "Për miratimin e planit lokal të veprimit për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036".*
12. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

**Z. Luli** bën leximin e rendit të ditës.

Vijohet me votimin e rendit të ditës, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Po ashtu para se të kalohet tek pikat e rendit të ditës vijohet me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, datë 26.01.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16 pika 2.

Procesverbali hidhet në votim, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e parë e rendit të ditës: *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2026".*

Kjo pikë nuk ka nevojë për relativim, prandaj kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pike 2: *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*

Edhe kjo pikë nuk ka nevojë për relativim, prandaj kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikë 3. të rendit të ditës: *Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër*”.

**Z.Luli** sqaron se si siç thënë edhe në mbledhjen e kaluar, kjo pikë vjen si rezultat i vakancës së krijuar në Këshillin e Qarkut Shkodër pas dhënies së dorëheqjes së Znj.Nika. Ai fton këshilltarët të bëjnë propozimet e tyre, dhe shton se votimi do bëhet në fund të rendit të ditës, për arsye që të operojmë me përgatitjen e dokumentacionit, i cili të do të jetë lista e votuesve, si edhe fletët e votimit me propozime të kandidatëve përkatës.

**Znj.Shala** në emër të grupit të saj, shprehet se për të njëjtën arsye si në mbledhjen e kaluar ato nuk do të marrim pjesë në votim.

**Znj.Duhani** merr fjalën dhe shprehet se si grup kemi rënë dakord që këtë vakancë ta plotësojmë me këshilltarin më të vjetër, Z.Gjergj Sokoli.

E vetmja kandidaturë e propozuar është Z.Sokoli.

Po ashtu **Z.Luli** sqaron se duke qënë se anëtarët e komisionit të mandateve nuk janë prezent në sallë, do duhet të krijojmë një komision për administrimin e procesit të votimit.

Nga ana e grupit të PS propozohet Znj.Petani dhe nga grupi i PSD-së Znj.Duhani.

Kalohet tek pika 4. e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për në ndryshim në VKB nr.54 datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”*”.

Relaton për këtë pikë **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme juridike në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

**Z.I.Sokoli**, merr fjalën dhe pyet: Në raport me projektbuxhetin sa shkon rritja? Në një buxhet që e kishte nivelin e pagave diku tek rreth 39-40%, dua të dija sa shkon me indeksimin e pagave.

Përgjigjet Znj.Dama duke thënë se ndoshta për llogaritjen mund t’iu sqarojmë mbledhjen e radhës sepse nuk e kam si përgjigje.

**Z.Pashuku**, shprehet se tek tabela e parë vëren që tek pagat e administratorëve, duhet të jetë maksimumi pasi ato kanë një shpërndarje të madhe gjeografike. P.sh administratori i njësisë Dajç mbulon 11 fshatra dhe besoj që kjo nuk ka efekt të madh në buxhet.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2027-2029"*.

Relaton për këtë pikë **Z. Ardit Behari** drejtor i drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Golemi** dhe thotë se tek tabela të ardhurave, taksa mbi tokën bujqësore, vërej që nga 2025 në vitin 2026 ka një rritje 2 herë. A është planifikuar rritje takse apo mendohet ndonjë formë tjetër të mbledhjes së kësaj takse?

Përgjigjet **Z.Behari** dhe thotë se pavarësisht se ne jemi drejtorja e taksave, taksën mbi tokën bujqësore planifikohet nga drejtorja e Bujqëësisë, prandaj për më tepër shpjegim mund të ketë kjo drejtori.

Për me tepër përgjigjet **Z.Mema**, duke thënë se parashikimi përse i përket taksës bujqësore, nuk bëhet fjalë për rritje tarife por duhet të konsiderohet fakti që jemi në proces të disa njësi administrative për certifikimin përfundimtar të pronave. Prandaj është planifikuar që edhe këto të llogariten në skemën e pagesës.

**Znj.Golemi** vijon duke thënë se përse i përket taksës së menaxhimit të mbetjeve, të gjelbërimit dhe ndriçimit do të ketë një lehtësi fiskale, nëse shohim në tabelën për 2025-2026 vërejmë një zbritje tek të ardhurat për mbetjet dhe gjelbërimin. Në njërin anë ka rritje kurse për ndriçimin publik zbritje. Si shpjegohet kjo?

Përgjigjet **Z.Behari**, duke thënë se duhen parë tabelat analitike për këtë dhe herës tjetër mund t'ju japim një përgjigje të saktë, ndoshta edhe nëpërmjet Këshillit.

**Z.Pashuku** shprehet se ka toka bujqësore që janë të përmbytura dhe propozoj që të hiqen nga inventari pasi nuk janë toka produktive, prandaj mendoj të hiqen nga taksa e vitit 2026.

Përgjigjet për këtë **Z.Mema** duke e vlerësuar si propozim dhe shton se do ta kemi në konsideratë për ta përfshirë në vendim.

**Znj.Shala** pyet lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, duke vërejtur që shifra është gati e dyfishuar. A do ketë një Bum ndërtimesh të reja? Së dyti, shton ajo shoh që taksa/tarifa vendore parashikohet afërsisht dyfishi i 2025. Si do arrihet kjo shifër? Kurse tek të ardhurat administrative vërehet një ulje, pse ndodh kjo?

Përsëri **Z.Behari** thotë se taksa e ndikimit në infrastrukturë sillet nga drejtorja përkatëse, e cila parashikon edhe lejet që do jepen në vitin në vijim. Ai shton se siç tha edhe më parë duhet që secila drejtori të jap informacion për parashikimet e veta, pavarësisht se ne jemi drejtorja e taksave. Kurse përse i përket tarifave administrative, ato janë gjoba dhe kamatë vonesa dhe kjo në fakt është shumë e vështirë të parashikohet saktësisht. Thjesht është bërë një parashikim i përafërt.

**Znj.Shala** pyet përsëri nëse dikush mund të na jap një shpjegim më të saktë për keto ndërtimet e reja sepse po ta mendojmë po shkojmë drejt vitit elektorale dhe pse është gjithë kjo rritje në një kohë që deri sot nuk ka patur leje ose krejt pak. A mendohet që Shkodra do të ketë kaq shumë ndërtime, sepse kemi dyfishim.

Përgjigjet për këtë Zv/Kryetari i Bashkisë **Z.Preka** duke thënë se nuk bëhet fjalë për ndërtimet. Patjetër që kemi aplikime për leje, por këtu kemi të bëjmë me parashikimet e drejtorisë mbi aplikimet që kemi, të cilat do sjellin të ardhura mbi këto leje që do të miratohen. Të gjitha janë konform ligjit dhe nuk shoh asgjë të keqe që Shkodra të zhvillohet.

**Z.Bjanku** shprehet se po flasim për të ardhurat për një periudhë afatmesme 2027-2029, në një kohë që kemi ulje të popullsisë. A ndikon kjo tek baza e taksapaguesve dhe sa është marrë në konsideratë një ulje e tillë?

Përgjigjet **Z. Behari** duke thënë se në fakt ne kemi rritje të nr. të bizneseve. Nuk e kuptoj se ku është zbritje në këtë rast?

Sqaron **Z.Bjanku** dhe thotë se kemi një institucion INSTAT që jep nr.e popullsisë për secilin Qark dhe për Bashkinë Shkodër ka ulje të popullsisë. Dhe llogjika është se kur ka ulje të nr. të popullsisë kemi edhe ulje të taksapaguesve. Taksapagues nuk janë vetëm bizneset por edhe personat fizik dhe subjekte të tjera. Mendoj që ky fakt duhet të ishte marrë në konsideratë në parashikimet e bëra.

Për më tepër sqaron **Z.Mema**. Të dhënat zyrtare që përdoren si në buxhetim, si nga Bashkia ashtu edhe nga Qeveria Shqiptare, përse i përket transfertave që na sjellin gjithmonë kanë për bazë rregjistrin e Gjendjes Civile, dhe nuk merret për bazë INSTATI. Në Gjendjen Civile figurojnë edhe qytetarë që jetojnë jashtë dhe që marrin shërbime, të cilat përkthehen në të ardhura për Bashkinë.

Përsëri **Z.Bjanku**, a keni një bazë ligjore përse thotë sepse nuk më duket normale të mos merret në konsideratë nr.efektiv i popullsisë.

**Z.Mema:** Patjetër që ka një bazë ligjore, të cilën do t'ju a vëmë në dispozicion sepse nuk mund të marr përsipër të bëj deklarata në cilësinë e një drejtuesi të Bashkisë.

**Znj.Golemi:** Janë parashikuar lehtësira fiskale për disa familje. Për këto familje që përfitojnë a bëhet llogaritja direkt nga Bashkia apo duhet të bëjnë aplikim, pasi jo të gjithë kanë informacion për këto lehtësi.

**Z.Behari:** Në bazë të informacionit që na sjell drejtorja e Shërbimit Social për kategori të caktuara përfituese, bëhen lehtësime fiskale për të gjithë dhe jo vetëm për ato që kemi evidentuar ne si drejtori.

Vijon **Znj.Golemi**, kemi rastepensionistësh p.sh, që i është dashur të vijnë të bëjnë aplikimin vetë, pasi nuk kanë qënë në dijeni të lehtësirave. A nuk do ishte më mirë për qytetarët që ky lehtësim fiskal të bëhej nga vetë Bashkia në sistem?

Përsëri **Z.Behari:** Pensionistët duhet të vijnë të bëjnë aplikimin pasi ne nuk kemi linjë direkte me Sigurimet Shoqërore, që e dijnë se kur personi del në pension, në Kemp etj. Duhet të dijmë që për pensionistët përfitojnë ato që nuk kanë fëmijë në moshë madhore.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse Znj. Shala shprehet kundër për pakënaqësitë që u thanë.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **25** vota Pro **13** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 6. *Projektvendim: "Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028", si dhe për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025.*

Relaton për këtë pikë **Z.Mema**, drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Shllaku**: Sot nuk po diskutohet për një shtesë buxheti që është 2.8 milion lek por po diskutojmë për një tregues zyrtar të performancës së Bashkisë Shkodër dhe është skandaloze që Bashkia Shkodër duke marrë grantin rezulton e 54 në 61 bashki në vend dhe kjo nga një total prej 100 pikësh ka marrë 14%, duke u krahasuar kështu me bashkitë më të vogla në vend. Pra Shkodra ka humbur mbi 18 milion grant për arsye të vlerësimit të treguesve. Pra kemi një performancë që lë shumë për të dëshiruar në krahasim me 4 vite më parë, ku Bashkia Shkodër ka dalë me performancën e parë në rank vendi, si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo sektoriale. Pyetjet e mia janë këto:

A është ky prioriteti i parë i një Bashkie, që ka dalë e fundit nga performanca, meqënëse këtë grant do ta përdorim për tabelat dixhitale?

A është bërë një analizë pse kemi marrë kaq pak pikë tek treguesit?

A ka një plan rikuperimi institucional për vitin e ardhshëm?

Përgjigjet për këtë **Z.Mema**: Janë konstatime që i kemi bërë edhe ne si staf i Bashkisë. Siç mund ta shihni, një pjesë e vlerësimit ka të bëjë me planet e fushave të ndryshme, që duhet të ishin miratuar. Konkretisht matja dhe indikatorët e performancës kanë qënë nga 1 Janari-17 Shtator, dhe ju e dini që jemi në proces të disa nga planet më të rëndësishme. Dhe këto kanë patur edhe peshën më të madhe në vlerësim. Me miratimin e tyre Bashkia Shkodër do marrë vlerësimin që i takon.

**Znj.Shkrela:** u kuptua përsa i përket planeve, por gjithsesi Bashkia Shkodër del 0, sado që të justifikoheni. Duhet të ishin miratuar me kohë. Ajo shton se është vendosur për hartat digjitale.

Turizmi nuk çalon tek hartat. Ju thoni që është rritur numri i turistave, që nuk e di me çfarë syri e shihni ju këtë, por gjithsesi turistët e huaj vijnë me guidë turistike, që kanë të përfshirë një paketë që çon në destinacionin e kërkuar. Mendoj që nevojat e Bashkisë Shkodër janë më të mëdha se hartat dixhitale. Mund të mendohet p.sh për familjet në nevojë etj. Ka plot shërbime publike që kanë mangësi dhe ku mund të ndërhyhet. Nuk mendoj që turizmi çalon nga dy monitorë dixhital.

Pyetje e diskutime të tjera për projektaktin nuk ka, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **34** vota Pro **2** Kundër **3** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *Projektvendim: “Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, projekti “Shtëpia që ndërton të ardhmen” – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç).*

Për këtë pikë Znj.Pode propozon se nuk ka nevojë për relatin, prandaj kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **39** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 8. e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative, 2026 – 2028”.*

Relaton edhe për këtë pikë **Z.Mema**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje e diskutime të tjera për projektaktin nuk ka, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **3** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 9. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.*

Përsëri relaton **Z.Mema**.

Fjalën e merr **Z.Bjanku**: Ky është një vendim, i cili faktikisht nga pikëpamja e teknikës që është përdorur, janë dy gjëra bashkë. Ai mendon se ndoshta më mirë do ishte një vendimmarrje e ndarë, më e qartë. Por në lidhje disa gjopa, për pjesën që ka të bëjë me policinë bashkiake mesa shihet marshi i tyre është shumë i lartë. Ai ka dy pyetje:

A ka policia bashkiake trajtimin e duhur, pasi ky nivel gjobash kërkon njohje shumë të mirë të Kodit rrugor dhe dispozitave të tjera, duke u nisur këtu prej kriterëve që kërkohen për të qënë polic bashkiak dhe atyre për të qënë polic shteti.

A kemi ne një sistem të mirë sinjalistik, për të patur një nivel të tillë gjobash?

Përgjigjet **Z.Rustemi**, drejtor i Policisë bashkiake për këtë, duke thënë se përsa i përket kritereve të pranit, ato janë identik me ato të Policisë së shtetit. Policët tanë bashkiak kanë të njëjtën aftësi siç e ka edhe Policia e shtetit. Për më tepër aktiviteti i Policisë bashkiake siç jemi të gjithë koshient është hapur shumë duke hasur shpesh herë problematika në terren për kontrollin e territorit. Duke qenë se kemi mangësi për reagimin ndaj këtyre shkeljeve kemi kërkuar ndihmën tuaj për të reaguar ndaj shkelësve. Nuk bëhet fjalë për shtesë në nivelin e gjobave por thjesht për një mundësi për ta kryer më së miri punën tonë, pasi nuk kemi akses në marrje masash, si p.sh: për parkim në korsi biçikletash, parkim në zonën e pedonales etj.

**Z.Shkaju:** Faktikisht nuk është mbedhur komisioni i rendit sepse kam dashur të them dy fjalë, por po i shpreh sot këtu. Mos ndoshta e keni tepruar me këto gjoba?

Sqarron këtu përsëri **Z.Rustemi** duke thënë se nuk bëhet fjalë për rritje gjobash por për akses në marrje masash për shkelësit. Ai thekson se gjobat janë ato ekzistueset, të parashikuara me ligj.

Pyetje të tjera nuk ka, kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi, kurse Znj.Shala shprehet kundër projektaktit.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **26** vota Pro **0** Kundër **14** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e radhës: *Projektvendim: “ Për një ndryshim në VKB nr.18 datë 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Nësia administrative Gur i Zi, fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Vitalia Albanie” i ndryshuar.*

**Z.Luli** sqaron se kjo pikë rivjen në Këshill, pasi nuk u miratua për arsye votash.

Propozohet që kjo pikë nuk ka nevojë për relativitet, prandaj kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër: *Projektvendim: “Për miratimin e planit lokal të veprimit për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036”.*

Relaton përsëri **Znj,Shllaku** drejtoreshë Mjedisi në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **40** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me votimin e pikës së tretë të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër”.*

Nga grupi i Kualicionit "BF" kërkohet, që para se të bëhet votimi, të vijohet me diskutimet jashtë rendit të ditës, por **Z.Luli** sqaron se në fillim duhet votohen projektaktet që kërkojnë miratim.

Siç u vendos në fillim të mbledhjes votimi do kryhet nga komisioni për administrimin e procesit të votimit. Hidhet në votim komisioni i ngritur, ku rezultojnë **27** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim.

### **Miratohet**

Vijohet me votimin. Votim ky që kryhet i fshehtë siç e parashikon rregullorja.

Pasi ka përfunduar votimi nga anëtarët e Këshillit, komisioni lexon rezultatin, ku rezulton se me **26 vota Pro**, fitues shpallet kandidati i vetëm **Z.Gjergj Sokoli**.

Kalohet tek pika e fundit e rendit të ditës: *Diskutime jashtë rendit të ditës*.

Fjalën e merr **Znj.Golemi**: Unë dua të ngreh shqetësimin e tregtarëve dhe banorëve të zonës së Zdrales. Në fakt investimi i Bashkisë aty është një investim që duhet lavdëruar për atë zonë megjithëse kam rezervat e mia për cilësinë e punimeve, duhet të kishte më shumë kontroll për cilësinë mendoj unë. Problemi im qëndron në oraret e lëvizjes së makinave. Ajo është zonë historike për tregti dhe nëse duam ta shndërojmë në zonë pedonale, restorantesh etj, atëherë duam të ndryshojmë historikun e asaj zone dhe kjo më duket pak e vështirë që zona në fjalë të ktheht në shëtitore. Megjithatë shqetësimi i banorëve dhe tregtarëve qëndron në faktin se aty nuk ka po qarkullojnë makina dhe po penalizohen. Duhet pranuar që makinat aty kanë krijuar shpesh herë kaos, por nuk duhet të ndalet krejtësisht lëvizja e makinave. Ndoshta vendosja e një sesnsi lëvizjeje do ishte më me vend sepse nëse vazhdohet kështu shumë dyqane do mbyllen ose do ndërrojnë destinacion.

Problem tjetër që ka krijuar kjo situatë me oraret është edhe kaosi që është krijuar në rrugët anësore aty. Prandaj kërkoj që të rishihet edhe njëherë për të mirën e banorëve dhe më tepër për bizneset që mbajnë familjet me dyqanet aty.

Përgjigjet **Z.Preka**: Përsa i përket cilësisë së punimeve, investimi nul është dorëzuar akoma dhe në momentin që do dorëzohet do shihet cilësia e punimeve dhe gjithçka. Kurse për faktin e ndikimit në tregtinë aty, mendoj që në zonat për këmbësore, pedonale tregtia është më cilësore dhe e sigurtë. Ajo zonë ka shërbyer për parkim makinash e për t'ia bërë jetën tregtarëve shumë më të vështirë se sa thoni ju. Ne si Bashki kemi pritur dhe kemi diskutuar edhe me grupin e interesit dhe është dakordësuar për një parkim i monitoruar nga Policia bashkiake. Është gjetur mirëkuptim dhe mendoj që dita ditës do shohim që do jetë për më mirë. Përsa i përket banorëve do procedohet në të njëjtën mënyrë si me Gjuhadolin, me karta residenti, për të aksesuar në shtëpitë e tyre.

**Z.I.Sokoli**: Në vijim të problemit të Zdrales, dua të shtoj se ne kemi një rrjet rrugor aty me 2-3 rrugë shkarkuese, të cilat kthehen në rrugë çorre. Për më tepër në lidhje me bizneset, kjo thjesht është ndërhyrje në konkurrencën e biznesit. Ajo është rrugë tregtare, e cila ka nevojë për akses direkt. Për më tepër që kufizimi si instrument duhet të kalojë në Këshillin Bashkiak sepse nuk është miratuar plani i mobilitetit. Është e vetmja rrugë në Shkodër që ka këtë kufizim. Nuk të bëjmë krahasim me Gjuhadolin sepse ka karakter krejt tjetër. Nuk është e njëjta tipologji rruge.

Për më tepër ju nuk i keni ofruar asnjë mundësi tjetër për akses aty. Ajo është zonë tregtare dhe duhet të ketë lëvizje të pakten me një sens. Ka patur edhe një peticion për këtë, i cili është depozituar në Bashki.

**Z.Luli** sqaron s ky peticion nuk i është përcjellë Këshillit Bashkiak.

Vijon **Z.I.Sokoli** duke thënë se pret përgjigje për këtë, pasi përgjigjia e dhënë nuk është shteruese përsa i përket edhe planit të mobilitetit.

Përgjigjet **Z.Preka**: Është pjesë e planit të mobilitetit dhe është miratuar me të. Megjithatë do bëjmë verifikimet tona.

Replikon **Z.Sokoli**, orari i kufizimit duhet të kalojë domosdoshmërisht në Këshill.

Përsëri **Z.Preka**: Ajo është zonë me trafik të kufizuar, është lënë një orar ku lejohet furnizimi për dyqanet. Siç e dimë në të gjithë botën funksionon në këtë mënyrë. Përsa i përket transportit publik, nuk mund të themi që nuk ekziston, po ashtu ka edhe vendparkime. Për më tepër e përmenda edhe ë parë, kjo gjë është dakordësuar me grupin e interesit.

Vijon përsëri **Z.I.Sokoli**, duke thënë se sheh një mungesë serioziteti edhe me situatën e Rrjollit. Ajo është zonë e Bashkisë Shkodër dhe është insitucioni që duhet t'i dalë krah komunitetit aty, duke u përpjekur që të shmang edhe konfliktin. Banorët kanë patur edhe një takim me kryetarin e Bashkisë, ku i është thënë se ai nuk ka kompetencë tek leja e ndërtimit. Unë kam një shkresë këtu që është dhënë akti i konfirmimit nga Bashkia Shkodër e marrë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila mbledh të gjitha të dhënat përsa i përket konfirmimit teknik me zonat e mbrojtura. Dhe Bashkia Shkodër është shprehur që është pro zhvillimit dhe nuk ka ndikim negativ në ekosistemin e zonës. Pra kjo bie ndesh me fjalët e Kryetarit të Bashkisë. Në Këshill kemi diskutuar edhe herë të tjera mbi lejet dhe unë jam quajtur si person që disinformon publikun sepse nuk njoh procedurën. Në fakt unë procedurën e njoh shumë mirë sepse të gjithë institucionet e linjës japin mendimin dhe aktin e konfirmimit për lejet në territoret e tyre. Kjo tregon se ne e përdorim publikun për ta manipuluar dhe jo për të punuar për to. Prandaj ftoj Bashkinë të mos vazhdojë më me këtë lloj sjelljeje dhe të shkojë atje, t'i kuptojë hallet e njëzëve dhe t'i zgjidhin ato.

Pika tjetër ka të bëjë me zonën e mbrojtur, si ka mundësi, pavarësisht institucionit kompetent, i cili thotë se cënohet zona e mbrojtur në këtë rast, kurse Bashkia thotë të kundërtën kur ka një argument të qartë që është plani i përgjithshëm vendor, i cili të jep 0 mundësi për të ndërtuar atje, të cilin Bashkia duhet si fillim ta zbatojë. Dhe kjo gjë duhet të ishte flamur për ju edhe pse ndoshta nuk ju shkon politikisht për shtat, por gjithmonë duhet të jeni në krah të qytetarëve.

Përgjigjet **Z.Preka**: E kuptoj që dëshiron ta kanalizosh drejt Bashkisë. Nuk është një situatë aspak e këndëshme. Patjetër që kryetari i Bashkisë i ka pritur ata banorë, i ka dëgjuar ankesat dhe pretendimet e tyre. Por nuk mund të përdorësh atë shkresë për të thënë që Bashkia nuk ju doli zot sepse Bashkia është e detyruar të respektojë ligjin në radhë të parë dhe theksoj që nuk jemi aspak të kënaqur me protestën aty. Ajo po bëhet për çështjen e pronësisë mes palëve. Dhe Bashkia nuk është gjykatë dhe mos disinformoni. Patjetër që çështjen e ndjekim me shqetësim por ndikimi i Bashkisë është 0 në lidhje me konfliktin që kanë. Në diskutimin që ato kanë patur me kryetarin janë shprehur pro zhvillimit në atë zonë por kanë problemin e pronësisë. As Bashkia as Këshilli Bashkiak nuk është gjykatë dhe nuk bëjnë gjyqe publike. I takon organevetë drejtësisë të gjejnë

zgjidhje sa më parë për ato banorë. Dhe përsa i përket konfirmimit, ne do i japim ato gjithmonë konform ligjit.

**Replikon Z.I.Sokoli:** Unë them që konfirmiteti juaj është i jashtëligjshëm...

**Z.Preka:** E di që do ta kanalizosh aty ku ke dëshirë, por konfliktin ato nuk e kanë fare për zhvillimin por kanë pretendime që toka i është grabitur. Prandaj mos i përdorni ato banorë...mos disinformoni. Është institucion tjetër, që jep konfirmitetin për zonën e mbrojtur. Ne japim konfirmitet për atë çka na takon. Ju e dini shumë mirë, që KKTU ka lëshuar lejen dhe jo Bashkia, prandaj mos shfrytëzoni situatën.

**Përsëri Z.I.Sokoli** shprehet se disinformimi është i juaji sepse ju i manipuloni njërëzit.

**Z.Preka:** Ju e dini shumë mirë që ato banorë janë pro zhvillimit të pronës prandaj mos shfrytëzo situatën aty.

**Z.I.Sokoli:** Qëndrimi im është i qartë se ju keni dhënë konfirmitetin dhe nuk është e vërtetë që nuk keni gisht në këtë leje ndërtimi. Në qoftë se ju konfirmitetin do ta kishit dhënë ndryshe, leja nuk do ishte miratuar.

**Z.Preka:** Ju po thoni të mos ta zhvillojmë pronën, të mos zbatojmë ligjin...

**Z.I.Sokoli:** Por është zonë e mbrojtur... Dhe nuk është zbatuar ligji. Po të mos ishte dhënë ajo leje, ai konflikt nuk do ishte sot.

**Përsërit Z.Preka:** Mos shfrytëzo situatën. Çdo procedurë është konform ligjit. Pyetini ato banorë, a dëshirojnë ta zhvillojnë pronën e tyre?

**Fjalën e merr Z.Shkja:** Në rradhë të parë dua t'i përgëzoj ato banorë për kurajon sepse prona është jetësore. Z.Sokoli ka të drejtë por harro, asht si edhe Z.Preka se kjo është politikë më e thellë. Pse nuk thoni ju pronarin, se kush po e zhvillon atë projekt. Problemi është më i madh. Kjo është politikë e atyre më lart. Dhe ato banorë e kalojnë mbi kurriz. Të tregojnë se kush ja ka vjedhur pronën, kush ja ka dhënë lejen? Duhet t'i mbështesim por në këtë rast nuk mund t'i ndihmojmë.

**Z.I.Sokoli** shprehet se si anëtarë i Këshillit Bashkiak ka të drejtën të kërkojë llogari kujdo që ka gisht në këtë situatë.

**Znj.Shllaku:** Ashtu si kolegët e mi edhe unë do cek pak çështjen e investimit në Zdrallë. Fatkeqësisht, kjo ka prek drejtëpërsëdrejti të gjithë ato familje aty dhe 50 subjekte që operojnë. Kjo Bashki po tregon dita ditës që të gjitha investimet po i bën si t'i tekten kryetarit të Bashkisë, pa konsultim, pa asnjë dëgjese publike me komunitetin. Po ndalem edhe tek këndet e lojrave. Është miratuar buxheti, jemi në vitin 2026 dhe nuk shoh asnjë kënd lojrash që po bëhet, madje edhe ato ekzistueset nuk janë sistemuar, përkundrazi janë të rrezikshme për fëmijët.

**Ndërhyn Z.Luli** duke thënë se ju nuk e keni votuar buxhetin...

**Znj.Shestani:** Ju si kryetar Këshilli duhet të drejtoni seancën e paanshëm dhe ai buxhet që është miratuar me votat e Socialistëve duhet të përdoret ashtu si duhet sepse janë taksat e gjithë qytetarëve të Shkodrës. Ne nuk e kena miratuar për arsyen sepse kanë qenë vjedhje të hapura që

Bashkia do t'i bëjë gjatë këtij viti. Nëse flasim për buxhetin e Bashkisë Shkodër, flasim si institucion. Ne sjellim shqetësimet e qytetarëve.

**Z.Luli:** Ju lutem Znj.Shestani, mos keqinformoni dhe mos i kanalizoni gjërat siç doni ju.

**Z.Osmanagaj:** Duke qenë se jemi vetëm ne në sallë, tregon edhe një herë atë për të cilën ne luftuam që diskutimet të mos liheshin në fund. Për këto problemet e qytetarëve a duhet të interesohet dikush? Sepse ato që u larguan, e kryen punën e tyre, vetëm duke ngritur vetëm kartonat. Prandaj këtu nuk ka vend për ironi...

**Z.Luli** sqaron se rendi i ditës ka të bëjë me projektvendimet dhe pika e 12-të është diskutime jashtë rendit të ditës. Prandaj u dakordësua që të procedohej në këtë mënyrë.

**Znj.Shllaku:** Ju lutem të mbajmë seriozitetin... se po e shohim edhe nga prezenca, seriozitetin e Këshilltarëve tjerë për shqetësimet e qytetarëve. Dua të ndreh një shqetësim të rajonit nr.5, sheshi i pallateve është përfshirë në buxhet por edhe sot që flasim vazhdojmë të mos kemi asnjë investim të kryer aty. Banorët aty kanë kërkuar takime rradhazi me kryetarin e Bashkisë. Kanë dërguar edhe shkresa vazhdimisht, por asgjë.

Do ndalem edhe tek zvarritja e pajustificuar e procedurave përsa i përket emërtesave të shesheve, busteve. Deri kur do vazhdohet kështu, ndërkohë që qytetarët ato dosje i kanë depozituar në Bashkinë Shkodër prej vitesh dhe nuk merren në konsideratë.

Së fundmi do thosha që vlen për tu përgëzuar propoganda që bën Bashkia Shkodër për punën e saj sepse rrealiteti në fakt është krejt i qartë dhe është për të ardhur keq për një Shkodër të papastër , jo transparente dhe një Bashki që nuk ka aspak llogaridhënie. Mjafon të shihni në facebook, "Shkodra asht dashni" dhe aty do shihni Shkodrën e vërtetë.

Përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se vërtetë Shkodra asht dashni, por nuk është dashuri që pas orës 10:30 të darkës të kapësh në foto kazanët e mbeturinave, kur janë duke i mbedh. Nuk është dashuri të fotografosh pjesët më të këqija të saj. Shkodra asht dashni në çdo moment e çdo sekond, edhe atëherë kur janë të pastruara dhe kur qytetarët e papërgjegjshëm i hedhin mbeturinat në tokë. Faktikisht do bëhen publike edhe gjobat edhe mënyrat se si hidhet qytetarët mbeturinar. Por të thuash që Shkodra është e pisët, nuk besoj se qëndron. Normalisht që ka gjithmonë vend për përmirësim por po punohet çdo ditë. Përsa i përket zonës së Zdrales është e vërtetë se ndryshimi i disa zakoneve aty has vështërsi, por është vërtetuar që vlera e pronës për ato banorë shumëfishohet me pedonalen. Ajo zonë ka për të patur impuls krejt tjetër zhvillimi dhe frekuentimi për turistët.

Ndërsa për rajonin nr.5, kam përshtypjen se ka qenë një ndër përfituesit kryesor të shumë projekteve. Sot kemi mbi 20 projekte që do implementohen në infrastrukturë.

**Znj Shkrela:** Është e vërtetë që ka projekte por tashmë u bënë 4 vite që ato banorë të rajonit nr.5 presin , por që nuk po realizohen ato projekte. Aty ka plot projekte të miratuara por të pazhvilluara. Përsa i përket Zdrales, që është edhe çështja më kryesore e qytetit. Ju thoni që me ndryshimet do përshtatem, por në fakt përveç jush nuk është përshtatur askush. Kuptoj që do t'i dilni zot edhe këtyre paçavureve që bëni në qytet në një kohë që duhet të vijë vetë kryetari i Bashkisë e t'i dal për Zot marrëzirave që bën dhe jo t'ju përdori ju mish për top. Zdralja ka qenë gjithmonë zonë tregtare dhe ju në vend që ta zhvilloni biznesin aty po e shkatërroni atë.

**Z.Preka:** si po e shkatërrojmë....

Vijon **Znj.Shkrela** duke thënë se ju vendosni ndalim lëvizjeje se ju teket ju, me vizionin tuaj. Por kush jeni ju që merrni vendime kështu... Ju me këto investimet imagjinare po shkatërroni Shkodrën, sepse nuk keni asnjë plan.... vendosni fasha oraresh pa marr parasysh se çfarë do ndodhi më pas.

A na sollën ndonjë shërbim këto semaforët që keni vendos, sepse deri kryeministri e mori vesht se është bërë hataja në Shkodër. Flasim për investimin e fundit në rrugën “Don Bosko”. Një shkollë aty ka sjellë shqetësimin e saj. Ajo rrugë pak e ngushtë ka qenë, tani është ngushtuar edhe më tepër vetëm për korsitë e biçikletave. Shpresoj të merret parasysh shqetësimi i shkollës. Pas shumë kohësh që keni prerë shirita imagjinare, u përfundua ajo rrugë, por në dëm të komunitetit. Prandaj kur t’i bëni punët duhet t’i dilni për Zot, pse jo edhe banorëve të Rjollit.

Vijohet me replika mes Znj.Shkrela dhe zv/kryetarit Preka.

Përsëri **Znj.Shkrela** shton se po i ushtrohet presion punonjësve të Bashkisë. Ju keni filluar t’i ndalni pagën për bindje politike. Bëni kontrolle të vazhdueshme nëpër kopshte, kontrolle të kota, në një kohë që shihni më mirë kushtet dhe shtoni mësues mbështetës. Prandaj mos bini kaq poshtë dhe mos u tregoni kaq të vegjël. Kur të jeni në rregull me kushtet atëherë bëni reprezale në kopshte.

**Z.Shkjau** pyet se kur do ndërhyhet tek rruga e Perashit për në Tepe, pasi është shumë problematike.

Përgjigjet **Z.Preka:** Ajo rrugë është pjesë e projektit që është miratuar tashmë dhe do implementohet shumë shpejt.

**Znj.Dama** shpehet në lidhje me shqetësimin e Znj.Shkrela duke thënë se është plotësisht e pavërtetë për presionin që u përmend. Por nuk mund të pretendojmë që drejtoria e arsimit të mos ushtrojë funksionet e veta për monitorimin e shërbimeve. Kurse në lidhje me mësueset mbështetëse dua të them se as ky shërbim nuk mungon nga ana e Bashkisë Shkodër.

**Z.Doçi** i drejtohet Z.Preka: Ju thatëmë herët që Shkodra nuk ka gropa në një kohë që asfalti është i prerë nga rotondo tek ish 5-Heronjtë dhe deri... në çdo rrugë tjetër. Pra ju nuk keni gropa por keni kanale. Edhe sot rrugët janë të arnuara dhe kjo është përgjegjësi e juaja që të kërkon llogari për punët që po kryhen në qytet. Është fakt që kemi dal Bashkia e 57-të në vend.

**Z.Kapcari** pyet se a mund ta dimë se kur është hedhur për herë të fundit asfalt nga Ndërmarrja e Shërbimeve publike në Shkodër, pasi ajo ka marr përsipër të kryejë këto shërbime.

Përgjigjet **Z.Preka:** Përsa i përket gropave e kanaleve nuk mund të pretendojmë që s’ka asnjë, por duhet të pranojmë që po punohet çdo ditë.

**Znj.Shestani:** Për mendimin tim ka rrugë sa të duash në qytet, që kanë nevojë për ndërhyrje. Aty ku banoj unë në rrugën “L.Shiroka” dhe “L.Saraçi” nuk është vënë rodë absolutisht. Po ashtu edhe para Kishës së madhe. Shpresoj të merren masa. Shqetësim tjetër i imi është një qendër shëndetësore në Gur të zi, që në dritaret e saj ka 92 kazanë mbeturinash dhe nuk e di se kur do marr zgjidhje ky shqetësim. Duhet të transferohen diku tjetër sepse është jashtë çdo logjike që të jenë aty, ku duhet të ketë higjenë maksimale. Po ashtu ajo shton se shqetësimi më i madh është që nuk është hera e parë që në pikën , *Diskutime jashtë rendit të ditës* këshilltarët socialistë nuk janë

prezent. Dhe kjo nuk është aspak serioze, në një kohë që të gjithë jemi të zgjedhurit e qytetarëve për të qënë zëri i tyre. A thua ato nuk kanë asnjë shqetësim nga komuniteti që përfaqësojnë apo vazhdojmë me atë që Shkodra është mrekulli. Mua më vret shumë indiferenca dhe kjo moskorrektesë e tyre. Do ju lutesa ju, që aderoni në këto forca politike, bëjini thirrje që t'i sjellin shqetësimet e qytetarëve.

**Z.Pashuku:** Shkodra ka edhe njësitë administrative dhe duke qënë që zv/kryetari është prezent sot do ju lutesha ta shihnit një rrugë në Bërdicë, rreth 3.3 km, që aty gropat prej vitesh kanë nevojë për arnim. Ky shqetësim është ngritur edhe në dëgjesat publike. Së dyti, unë kam thënë edhe herë tjetër që duhet që administratori i Bërdicës bashkë me drejtorin e ujësjellësit të diskutojnë për mundësinë e përcaktimit e një pike për lidhjen e një çezme publike. Duke patur parasysh që projekti i ujësjellësit është gati prej vitesh, prandaj besoj se tashmë duhet ndërhyrë në implementim.

Përsëri **Z.I.Sokoli:** Një problem që nuk u prek janë edhe përmbytjet. Në Obot kemi patur dy herë përmbytje. Kemi edhe dy vërshime në qytet. Pyetja ime është se kur do fillojnë dëmshpërblimet që të rindizet ekonomia e këtyre zonave. Dhe në vijim të shqetësimeve të shprehurave edhe nga kolegët, a janë zbatuar standartet e kërkuara në rrugën Roza Lejn dhe tek ajo e Don Boskos? Aty nuk kalon dot një zjarrëfikëse. Prandaj nuk mund të jemi me dy standarte. Kurse përsa i përket mbeturinave, shkoni në "Livade" dhe pas stacionit të trenit dhe do shihni fusha inertesh. A e ekziston Bashkia për ato zona, apo jo?

Përgjigjet **Z.Preka** duke thënë se shpërblimet do bëhen pasi të përfundojë faza e evidentimit të dëmeve, sepse nuk është krejtësisht në kompetencën tonë.

*Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.*

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 27.02.2026. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 15 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

**V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.**

**Sekretar**

**Sabina DANAJ**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**



**Zbardhi Pr/verbalin:**

**Irma Sulishti**

